



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 23.06.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/ L-040, nenit 38.1 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr.03/L-149 dhe kërkesës së drejtorit të Drejtorisë për Punë të Përgjithshme Administrative për zgjatjen e orarit zyrtar të punës në sektorin e gjendjes civile të Komunës së Gjakovës, me qëllim të përmbushjes së kërkesave të bashkatdhetarëve që vijnë nga diaspora , me dt: 23.06.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Nëpunësit e sektorit të gjendjes civile të Drejtorisë për Punë të Përgjithshme Administrative të Komunës së Gjakovës, duke filluar nga data 06 korrik 2015 deri me 15 Shtator 2015, do të punojnë me orar të zgjatur si në vijim:

- Nga dita e hënë deri të premtën, do të punohet me orar të zgjatur nga ora 08:00 deri në orën 18:00, ndërsa puna me palë fillon nga ora 08:30 deri në orën 17:30.
- Obligimi për punë me orar të zgjatur vlen vetëm për nëpunësit e sektorit të gjendjes civile të cilët punojnë në ndërtesën kryesore të administratës komunale , ndërsa nëpunësit e 12 zyreve të vendit nuk janë të obliguar për punë shtesë, përkatësisht në zyrat e vendit do të punohet sipas orarit të rregullt të punës nga ora 8:00 deri në orën 16:00.

2. Nëpunësit civil të cilët do të angazhohen për punë shtesë të cekur në pikën 1 të këtij vendimi, do të kompensohen në pajtim me Ligjin për Pagat e Nëpunësve Civil nr.03/L-147 .

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të përkujdeset drejtori i DPPA-së dhe udhëheqësja sektorit të gjendjes civile .

4. Vendimi iu dorëzohet:

- Drejtorisë për Punë të Përgjithshme Administrative
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Udhëheqëses së Sektorit të Gjendje Civile
- Zyrës së Personelit
- Arkivit

Kryetarja e Komunës,

Znj. Mimoza Kusari-Lila